



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prilijeno Received/Delivered	17.01	2024	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtjupa Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKPMH/4	309/2024		1/15



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1471/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1471/2023 të datës 04.12.2023, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi: Ndërtesa e Qeverisë, në Prishtinë, kundër organit të punësimit Zyrës së Kryeministrit, në çështjen juridike “Masë disiplinore-vërejtje”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.01.2024, mori këtë:

### V E N D I M

I. Shfuqizohet masa disiplinore “Vërejtje me shkrim”, e shqiptuar me datë 03.11.2023 nga Zv. Sekretari të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit, ndërsa lënda kthehet në *rishqyrtim* dhe *rivendosje*.

II. Obligohet Zv. Sekretari të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit që të bëjë zbatimin e këtij Vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ashtu që duhet të rishqyrtoj dhe rivendos lëndën e ankues sikurse në pikën I të dispozitivit.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Zyrën e Kryeministrit me datë 04.12.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit Nr.prot.7207/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore “Vërejtje” të datës 03.11.2023 të shqiptuar përmes e-mailit zyrtar nga Zv. Sekretari të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit.



Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore janë shkelur dispozitat e nenit 47 dhe 48 të Ligjit Nr.005/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 56 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik për shkakun se vërejtja nuk përmban në mënyrë specifike shkeljen e përcaktuar sipas dispozitave të ligjit material dhe se akti nuk ka arsyetim mbi bazën e të cilit mund të kuptohet shkelja e bërë me kërkesën që Këshilli ta anulojë aktin e kontestuar, sikurse e njëjta pretendon se dokumenti në fjalë është protokolluar para se të jetë punësuar në ZKM dhe se kërkesa nga Zv. Sekretari i Përgjithshëm nuk ka qenë sipas specifikave të emërtimit të shkresës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 06.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Zyrës së Kryeministrit. Ndërsa Këshilli më datë 13.12.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 7207/2023 të parashtruar nga ankuesi më datë 04.12.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokumentin e datës 10.09.2015 me Nr.152/2015 nga Kryeministri i Republikës së Kosovës për Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës; Shkresën e datës 08.09.2017 nga Sekretari i Përgjithshëm-ZKM për Shefin e Protokollit të Zyrës së Kryeministrit; E-mailin e datës 03.11.2023 dërguar nga A.K për V.S me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; E-mail i datës 03.11.2023 dërguar nga ankuesja për A.L; Foto aparature e sistemit; E-maili i datës 03.11.2023 dërguar nga H.K për ankuesen; E-maili i datës 06.11.2023 dërguar nga ankuesja për S.S me korrespondencën e bashkangjitur; E-maili i datës 01.12.2023 dërguar nga ankuesja për Këshillin; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 06.12.2023; Përgjigja në ankesë e datës 13.12.2023; E-mailin e datës 06.12.2023 nga A.K për arkivin ZKM; Akt emërimin e ankueses i datës 22.02.2016; Përshkrimin e detyrave të punës së ankueses; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.01.2023; Përgjigja e datës 12.12.2023 e UD. Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së; Foldersi i arkives-ZKM2015; Shkresë e datës 10.09.2015 me shifër protokollit:2366 dërguar nga Kryeministri i për Kryetarin e Kuvendit me materialin e bashkangjitur; E-mailin e datës 03.11.2023 nga Arkiva e ZKM për A.K; vërejtja me shkrim e datës 03.11.2023; E-maili i datës 06.11.2023 dërguar nga A.L për ankuesen; E-maili i datës 03.11.2023 dërguar nga A.K për ankuesen; E-maili i datës 03.11.2023 dërguar nga ankuesja për A.K; E-maili i datës 03.11.2023 dërguar nga A.K për ankuesen; E-maili i datës 03.11.2023 dërguar nga ankuesja për A.K; Shkresë e datës 10.09.2015 dërguar nga Kryeministri për Kryetarin e Kuvendit (shkresë e pa protokolluar); Shkresë e datës 08.09.2017 nga Shefi Protokollit të Kryeministrit për Sekretarin e Përgjithshëm të ZKM-së; Shkresë "komunikim përmes telefoni-foto"; E-mailin e datës 03.11.2023 dërguar nga H.K për A.B; E-maili i datës 03.11.2023 dërguar nga H.K për ankuesen; E-maili i datës 03.11.2023 dërguar nga H.K për A.Sh; E-maili i datës 11.12.2023 dërguar nga ankuesja për H.K E-maili i datës 27.10.2023 dërguar nga A.L për ankuesen; E-maili i datës 27.10.2023 dërguar nga A.K për A.L; E-maili i datës 27.10.2023 dërguar nga S.M për ankuesen; Zarf postar i datës 12.12.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë, të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses duhet të kthehet në *rishqyrtim* dhe *rivendosje*, sepse:



Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesja sipas aktit të emërimit të datës 22.02.2016, është e punësuar në Arkivin e Qeverisë së Republikës së Kosovës në pozitën e punës "Udhëheqëse e Arkivit" ndërsa Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit të Kosovës me datë 03.11.2023 i ka shqiptuar masën disiplinore "vërejtje me shkrim" më shifër: 2109 me arsyetimin se ankuesja për shkak të neglizhimit të detyrave të punës dhe mos përmbushjes së detyrave të punës sipas përshkrimit të vendit të punës.

Me qëllim të shqyrtimit të ligshmërisë së pretendimeve ankimor të ankueses, Kolegji i Këshillit ka analizuar përmbajtjen e aktit të goditur me këtë ankesë, respektivisht vërejtën e datës 03.11.2023 të shqiptuar nga Zv. Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së ndaj ankueses dhe ka gjetur se Zv. Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së në aktin e goditur iu ka referuar dispozitave të nenit 29, 31, 57 paragrafi 1 dhe nenit 58 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-1967 për Zyrtarët Publik, me arsyetimin se ankueses i është kërkuar gjetja e dokumentit të arkivuar "Marrëveshja e Brukselit për Asociacionin e vitit 2015", ndërsa e njëjta nuk ka arritur të sigurojë dokumentin në fjalë, ashtu që **citohet** Zv. Sekretarin e Përgjithshëm të ZKM-së, me **deklarimin**: "e kam lajthitur kabinetin e Kryeministrit dhe Sekretarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës se në Zyrën e Kryeministrit përkatësisht në Arkivin e ZKM-së nuk ekziston ky dokument, në ditën e njëjtë kam pranuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Dokumentin "Marrëveshja për Asociacionin e Vitit 2015" e cila është protokolluar nga arkiva e ZKM-së i ishte dërguar Kuvendit të Republikës së Kosovës me datë 10.09.2015".

Kolegji i Këshillit, me qëllim të vlerësimit të bazës ligjore të referuar nga Zv. Sekretari i Përgjithshëm të ZKM-së analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-1967 për Zyrtarët Publik nenit 29, 31, 57 paragrafi 1 dhe nenit 58 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "29. Zyrtarja/i publik ka për detyrim të veprojë në përputhje me urdhrin e marrë nga mbikëqyrësja/i apo zyrtarja/i tjetër me kompetenca kontrolli ndaj saj/tij, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të brendshme të institucionit. 2. Në rastet kur zyrtarja/i publik dyshon për paligjshmërinë e urdhrin të mbikëqyrësit, ajo/ai nuk e zbaton urdhrin, por informon menjëherë mbikëqyrësen/in e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin me shkrim nga ana e mbikëqyrëses/it të personit që ka dhënë urdhrin. 3. Zyrtarja/i publik është i detyruar të zbatojë urdhrin e konfirmuar me shkrim, sipas paragrafit 2. të këtij neni, me përjashtim të rastit kur zbatimi i tij përbën vepër penale; 31. Zyrtarja/i publik duhet të ushtrojë detyrën e saj/tij me përgjegjshmëri dhe mban përgjegjësi të plotë sipas legjislacionit në fuqi, për çdo veprim apo mosveprim të saj/tij në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi. 2. Zyrtarja/i publik është e detyruar të shfrytëzojë orarin e punës me efikasitet dhe vetëm për kryerjen e detyrave të saj/tij të punës; 57.1. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për shkelje të lehta janë: 1.1. vërejtje verbale; 1.2. paralajmërim me shkrim; 1.3. vërejtje me shkrim dhe 58.1 Masat disiplinore për shkeljet e lehta shqiptohen nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe/apo nga udhëheqësja/i më i lartë administrativ."

Kolegji i Këshillit nga konstatimi i gjendjes faktike sipas shkresave të lëndës dhe analizimit të bazës ligjore ka ardhur në përfundimin se Zv. Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "vërejtje me shkrim" ndaj ankueses ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material ngase, ankueses masa disiplinore i është shqiptuar me arsyetimin, **citohet**: "për shkak të neglizhimit të detyrave të punës dhe mos përmbushjes së detyrave të punës sipas përshkrimit të vendit të punës", e që sipas nenit 56 paragrafi 1 dhe 4 nën paragrafi 4.1 dhe 4.2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik një shkelje e tillë përcaktohet të jetë shkelje e rëndë, sikurse: "54.1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda; 54.4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës" ndërsa masat disiplinore lidhur me shkeljet e supozuara të cilat janë shkelje të rënda ka kompetencë t'i shqiptojë vetëm Komisioni Disiplinor sikurse përcaktohet me dispozitat e 58 paragrafi 1 të Ligjit



Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si: "Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor", nga rrjedh se Zv. Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së me rastin shqiptimit të masës disiplinore të ankueses ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material ashtu që në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurës së Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material." dhe si e tillë vërejtja me shkrim e datës 03.11.2023 është akt administrativ i paligjshëm për shkak të shkeljeve të ligjit material dhe dispozitave të LPPA-së, ngase Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së është kompetent për shqiptimin e masave të lehta disiplinore kur kemi të bëjmë me shkelje të lehta disiplinore ndërsa kualifikimi apo arsyetimi i dhënë në masën e shqiptuar hynë në kuadër të shkeljeve të rënda sikurse edhe arsyetimi i aktit të kontestuar lidhur me bazën e referuar ligjore është i mangët, ngase për palën është e paqartë interpretimi dispozitave ligjore të dhëna si në aktin e kontestuar, prandaj mbi këtë bazë vërejtja e datës 03.11.2023 është shfuqizuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi ndërsa lënda kthehet për rishqyrtim dhe rivendosje tek organi që e ka nxjerr aktin e kontestuar.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës po ashtu ka gjetur se ankuesja nuk ka arritur ta siguroi shkresën e kërkuar dhe të protokolluar, dhe se kjo gjë konstatohet përmes shkresës së e-mailit zyrtar të datës 03.11.2023 dërguar nga ankuesja për Zv. Sekretarin e Përgjithshëm të ZKM-së, sikurse konstatohet fakti se shkresa e kërkuar me titull "Marrëveshja e Brukselit për Asociacionin e vitit 2015" sikurse e potencon edhe Zv. Sekretari i Përgjithshëm në vërejtjen e datës 03.11.2023, realisht shkresa e kërkuara nuk është titulluar si e tillë, respektivisht kontesti apo shkresa e kërkuar titullohet "Informatë lidhur me Marrëveshjet e arritura në Bruksel me 25 gusht 2015" e cila është dërguar nga Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës me datë 10.09.2015, gjegjësisht është shkresë dalëse, dhe se arsyetimi i ankueses përputhet me gjetjen e konstatuar ngase e njëjta arsyetohet se administrimi elektronik i shkresave duhet të ketë qartësi të referimit për kërkim të shkresës e në rastin konkret nuk janë përputh referencat, prandaj edhe ka ardhur deri tek vonesa e shprehur në fjalë, mirëpo Kolegji i Këshillit duke vlerësuar se institucioni punëdhënës, gjegjësisht udhëheqësit e drejtpërdrejtë apo zyrtari kryesor administrativ janë ata që fillimisht e vlerësojnë nëse një nëpunës civil ka kryer apo jo shkelje disiplinore dhe tek pas konstatimit të dhënë dhe të shprehur përmes aktit administrativ, më pastaj vlerësohet meritorisht lënda nga ana e Këshillit, gjegjësisht kjo është arsyeja që lënda e ankueses është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosjes, ngase Këshilli nuk ka vendosur meritorisht në këtë rast pasi që akti i goditur me këtë ankesë apo vërejtja e datës 03.11.2023 ka përmbajtur të meta të përcaktuara me dispozitat e LPPA-së, ndërsa ligji material është zbatuar gabimisht.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se, Zv. Sekretarit të Përgjithshëm me rastin e rishqyrtimit të lëndës së ankueses duhet të marrë përbazë pikëpamjet juridike të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi dhe nëse pas rivlerësimit të situatës së dhënë vlerëson se ankuesja është përgjegjëse për shkelje disiplinore, fillimisht duhet të konstatojë se shkelja disiplinore në kuadër të cilave shkelje hynë duke marrë për bazë dispozitat e nenit 56 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe më pastaj të procedojë tutje me veprimet procedurale, mirëpo në secilën rrethanë, akti përmes së cilës konfirmon vullnetin e organit publik që cenon apo supozohet se mund të cenojë të drejtat e palëve në procedurë që burojnë nga marrëdhënia e punës duhet të respektojë dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe të ligjit material.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër **A.nr.1471/2023**.

**Elakron GASHI**

  
Zyrtar i lartë për bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Zv. Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.